



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12 paragrafët 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 paragrafi 1 shkronja b) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenin 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2, nenin 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, nenin 11 dhe nenin 16 të Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor, Udhëzimin Administrativ nr.24/2015 të MMPH mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Udhëzimin Administrativ nr.08/2017 të MMPH mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit nr.20/2360/1-243/20 datë 23.07.2020 (*Shkresa përcjellëse nr.2360-2/20 datë 11.08.2020*) për Pëlqim Mjedisor për Vlerësimin Strategjik Mjedisor-VSM për Hartën Zonale të Komunës së Podujevës-HZK, Vendimin e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përcjellur përmes Shkresës SP-02 nr.prot.1653/22 të datës 30.03.2022 për dhënien e pëlqimit për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2022-2030, Raportin e Shqyrtimit Publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës, si dhe nenit 15 paragrafi 1 dhe 2.4, nenin 19 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 datë 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, mori këtë,

VENDIM PËR MIRATIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS (HZK) PËR PERIU DHËN 2022-2030

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Harta Zonale e Komunës së Podujevës për periudhën kohore 2022-2030.

Neni 2

Harta Zonale e Komunës së Podujevës është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për periudhën kohore tetë (8) vjeçare 2022-2030.

Neni 3

Harta Zonale e Komunës së Podujevës për periudhën kohore 2022-2030 nga neni 1 i këtij Vendimi, përmban pjesën tekstuale dhe grafike, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor në kopje fizike dhe digjitale dhe është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, përkatësisht me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2022-2030, Harta Zonale e Komunës do të mbizotëroj ndaj çfarëdo Plani të mëhershëm të Zhvillimit Urban ose Plani të mëhershëm Rregullues Urban.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen të gjitha organet Ekzekutive të Komunës.

Neni 6

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 16 dhe 17 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës.

Nr.prot. 01-020/02-0030654/22
Podujevë, datë: 29 prill 2022

